

# Gruas Kosovare

## "Zëri i Votuesve" takohet me përfaqësues të Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor

### përmbajtja

- 2 Gratë aktiviste nga Izraeli vizitojnë Kosovën
- 2 Publikohet Raporti "Më Shumë Se Vetëm "Fjalë Në Letër"
- 2 RrGGK merr pjesë në prezantimin e studimit "Kosova pas Luftës"
- 3 U shënua muaji kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore
- 3 Dekada e Qendrës Kosovare për Rehabilitim
- 3 Tetori – Muaji Ndërkombëtar i Luftës kundër Kancerit të Gjirit
- 4 Qendra për Mirëqenien e Gruas shënon 16 aktivizëm kundër dhunës ndaj gruas
- 4 QTSJGJ dërgon letër të hapur Institucioneve Kosovare

### njoftimet

Kuvendi Vjetor i RrGGK-së  
**12 Dhjetor**  
**ora 10:30**  
**"Villa Gërmia"**  
**Prishtinë**

**JANAR 2010**  
**10 Vjetori**  
**i**  
**RrGGK-së**

Gjatë muajit shtator, Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) ka organizuar nënshkrimin e peticionit "S'ka Ujë, S'ka Vota". Ky peticion në vete përmban 2 kërkesa: kërkesën për ujë të pijshëm 24 orë si dhe përmirësim të sistemeve të ujërave të zeza. Ky peticion u organizua si rezultat i nevojave të qytetarëve të Kosovës, të shprehura nëpërmjet linjës telefonike "Zëri i Votuesve" në numrin 0800 201 401.

Gjithsejtë janë bërë 2829 nënshkrime nga qytetarë të pothuajse tërë Kosovës. Probleme janë hasur vetëm në komunën e Mamushës, ku është ndaluar nënshkrimi i peticionit nga zyrtar komunal. Peticioni është përkrahur edhe nga aktivistët vullnetarë të Kryqit të Kuq të Kosovës.

Me 3 nëntor, koordinatorja e projektit "Zëri i Votuesve", u takua me përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Prezent në

këtë takim ishin këshilltarët politik të Ministrisë Mahir Yagcilar, z. Husnia Beshkoviç, z. Hazir Cadraç, znj. Gynaj Hallaç, znj. Ermira Bojku si dhe drejtori i Ujësjellësit Regjional Batllava z. Skender Bublaku.

Pas prezantimit të peticionit, dhe numrit të nënshkrimeve të marra, përfaqësuesit e MMPH-së paraqitën problemet që ata hasin në punën e tyre, për të përmirësuar gjendjen e ujit të pijshëm dhe të sistemeve të ujësjellës. Mungesa e fondeve ishte njëra prej pengesave që pamundëson përmirësimin e këtij problemi. Gjithashtu, pati dhe premtime se gjendja e ujit të pijes do të rregullohet, duke thënë se ky problem është edhe prioritet i kësaj ministrie, mirëpo një gjë e tillë është e pamundur të ndodhë në një të ardhme të afërt. Që qytetarët e Kosovës të kenë ujë të pijshëm në dispozicion të tyre 24 orë, do të duhen së paku edhe 5 vite, thanë përfaqësuesit e

kësaj ministrie.

Ministrisë gjithashtu i është bashkangjitur edhe një letër rekomandimi me mundësitë se si do të mund të rregullohet problemi i ujit të pijshëm. Ndër këto rekomandime hyjnë; gjobat të cilat duhet të paguhen nga personat të cilët e keqpërdorin ujin, shpenzojnë ujin e pijshëm; hedhin mbeturina apo bëjnë derdhjen e kanalizimeve në ujëra që përdoren për pije; të krijohet Eko-Fondi nga gjobat e lartpërmendura; angazhim më i madh i inspektorëve si dhe monitorim i punës së tyre; të njoftohen qytetarët për masat që do të ndërmerren në rast të keqpërdorimit të ujit të pijshëm (nëpërmjet mediave elektronike dhe të shkruara).

"Zëri i Votuesve" me këtë iniciativë edhe një herë ka dëshmuar gatishmërinë për të dërguar kërkesat e qytetarëve në adresë të duhur, gjë që do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

## Rrjeti i Grave në të Zeza publikojnë librin me rrëfime të grave

Me 12 tetor në Hotel Prishtina u bë publikimi i librit "Ana Femërore e Luftës", organizuar nga Kvinna till Kvinna dhe RrGGK.

Libri është botim i Grave në të Zeza nga Serbia dhe përmban rrëfimet e grave dhe përvojën e tyre gjatë luftës në Kosovë, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Serbi.

Në mesin e miqve dhe partnerëve lokal e ndërkombëtar ishin edhe aktivistët nga Izraeli, organizatat e grave hebreje dhe palestineze të cilat pas vizitës në Serbi po qëndronin në Kosovë. Versionin elektronik të këtij libri mund ta gjeni në:

[www.womensnetwork.org](http://www.womensnetwork.org)



## Gratë aktiviste nga Izraeli vizitojnë Kosovën

Nga 11 - 16 tetor, me përkrahjen e organizatës suedeze, Kvinna till Kvinna, RrGGK ishte nikoqire e një delegacioni të organizatave të grave nga Izraeli dhe Palestina. Ato së pari kaluan disa ditë në Serbi dhe pastaj erdhën në Kosovë së bashku me Rrjetin e Grave në të Zeza.

Qëllimi i vizitës së tyre është që të shkëmbejnë përvoja me organizatat e grave në Ballkan.

Ky delegacion vizitoi organizatat e grave në Prishtinë si: Dera e Hapur dhe Qendra Kosovare për Studime Gjinore. Në Gjilan vizituan Qendrën "Liria" ndërsa në Gjakovë, organizata Medica ishte nikoqire e këtij delegacioni. Poashtu ato u njofuan edhe me aktivitetet e organizuara në Mitrovicë gjatë vizitës në CBM (Community Building Center) dhe në Ugljare kishin rastin të njoftohen me aktivitetet e organizuara nga rrjeti i organizatave serbe të Kosovës.

Me 23 nëntor, në Ndërtesën e Qeverisë, u publikua raporti "Më Shumë se Vetëm "Fjalë në Letër"? Përgjigja e Organeve të Drejtësisë Ndjaj Dhunës në Familje", organizuar nga Agjencia për Barazi Gjinore (Zyra e Kryeministrit), Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) në Kosovë dhe Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës.

Duke u bazuar në intervista me më shumë se 60 përfaqësues të institucioneve, 96 viktimat të dhunës në familje dhe hulumtimet e mëherëshme, ky raport identifikon çështjet që kanë të bëjnë me legjislacionin ekzistues dhe zbatimin e tij. Të gjeturat dhe rekomandimet të cilat rezultojnë nga to kanë për qëllim t'i kontribuojnë hartimit të Ligjit të ri për mbrojtje kundër dhunës në familje, Strategjisë kombëtare dhe Planit të veprimit kundër dhunës në familje edhe legjislacionit tjetër i cili qeverisë ndjekjen penale të krimeve të kryera në marrëdhëniet familjare, procedurat operative dhe punën e institucioneve

përgjegjëse për sigurimin e qasjes në drejtësi.

Raporti vlerëson performancën e gjyqtarëve në ofrimin e mbrojtjes kundër dhunës në familje përmes mekanizmeve siç janë urdhrat për mbrojtje; ndjekja penale e akteve të dhunës në familje; hetimin e akteve të dhunës në familje nga Policia e Kosovës, si dhe veprimeve për të mbrojtur viktimat nga dhuna e mëtejshme; puna e institucioneve dhe organizatave të ndryshme përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të viktimave gjatë qasjes së tyre në drejtësi; dhe perceptimet e qytetarëve për sistemin gjyqësor, që mund të ndikojnë në vendimet e tyre për të kërkuar drejtësi apo për të heshtur. Ra-

## Publikohet Raporti "Më Shumë se Vetëm "Fjalë Në Letër"



porti përfundon me rekomandime për hartuesit e politikave dhe institucionet individuale drejt rritjes së qasjes në drejtësi për viktimat e dhunës në familje.

Raporti është në dispozicionin tuaj në faqen e internetit të UNDP-së ([www.ks.undp.org](http://www.ks.undp.org)), të RrGGK-së (<http://www.womensnetwork.org>), dhe Qeverisë së Kosovës (<http://www.ks-gov.net/portal/eng.htm>).

## RrGGK merr pjesë në prezantimin e studimit "Kosova pas Pavarësisë"

Me 27 nëntor në Vjenë të Austrisë, Renner-Institute prezantoi Raportin Studimor "Kosova pas pavarësisë- A ka arritur misionin i BE-së përmes EULEX-it të përbush misionin e saj ashtu siç është premtuar".

Qëllimi i këtij prezantimi është që të bëjë një analizë mbi misionin e EULEX-it në Kosovë. Në Dhjetor 2009 bëhet një vit prej kur Misioni i EULEX-it në Kosovë zyrtarisht ka filluar punën e tij. Deri më tani të dhënat mbi këtë mision jashtëzakonisht të shtrenjtë, janë më se dëshpëruese-suksesi i prituri mbi promovimin e sundimit të ligjit ka dështuar, Veriu i Kosovës ende kontrollohet

nga Beogradi. Legjitimiteti i "status-neutral" i misionit të BE-së është i ulët në të dyja anët, Serbët dhe Shqiptarët e Kosovës- gjë që mund të dëshmohej në bazë të analizave të bëra ku del se 90 % e popullatës së Kosovës nuk pajtohet me praninë e misionit të EULEX-it dhe politikave të BE-së në Kosovë. Strategjia e përgjithshme e misionit të BE-së në Kosovë nuk dallon shumë nga ajo e UNMIK-ut. Brukseli ende nuk ka dalë me ndonjë strategji të qartë mbi procesin e ndërhyrjes së EULEX-it në Kosovë.

Përveç Drejtoreshës Ekzekutive të RrGGK-së, në këtë prezantim morën pjesë: Vedran Dzihic dhe

Helmut Kramer, që të dy profesorë në Universitetin e Vjenës si dhe bashkautorë të këtij raporti, Ulrike Lunacek-deputete e parlamentit të BE-së raportuese për Kosovën, Dominique Orsini - Shef i Njësisë për politika në EULEX; Albert Rohan ish-zëvendës i të dërguarit të posaçëm për Kosovën, si dhe Hannes Swoboda-

Deputet-Zëvendëskryetar i grupit Socialist, Anëtar i Delegacionit të BE-së në Kosovë. Më shumë informata rreth këtij prezantimi mund të gjeni në: <http://www.renner-institut.at/fremdspr/frengl.htm>



## U shënua muaji kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore

Qendra Mbroj Viktimën Parandalon Trafikimin (QMVPT) gjatë muajit Tetor, Muajit Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore ka zhvilluar një sërë aktivitetesh. Janë mbajtur dy trajnime: Trajnim vetëdijesues në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore me përfaqësuesit e organizatave joqeveritare –OJQ si dhe trajnim senzibilizues dhe vetëdijesues në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore dhe të drejtave të fëmijëve me qëllim të raportimit të drejtë në mediumet e shkruara në Kosovë. Përveç aktiviteteve të rregullta vetëdijesuese për trafikimin e qenieve njerëzore që realizohen në Qendrën e Rehabilitimit, bazuar në modulën përkatës, stafi i Qendrës MVPT së bashku me vullnetarët nga Departamenti i Psikologjisë ka organizuar edhe dy aktivitete tjera.

Nën udhëheqjen e koordinatorës së Qendrës së Rehabilitimit dhe vullnetares nga Departamenti i Psikologjisë, gjatë muajit Tetor, grupi i përfitueseve ditore, i përbërë nga tetë vajza ka punuar në përgatitjen e një shfaqjeje teatrale. Kjo



pjesë teatrale përmban sekuenca të procesit të rekrutimit, rrëfimit të viktimës para audiencës për përjetimet e saj gjatë situatës së trafikimit, mënyrën e shpëtimit nga kthetrat e trafikimit si dhe sekuenca të procesit të rehabilitimit të viktimës. Porosia e shfaqjes është sikurse dhe vet titulli i saj "Trafikimi me njerëz paraqet RREZIK për të gjithë". Gjatë muajit Tetor, kjo shfaqje është prezantuar fillimisht në Qendër të Rehabilitimit, para përfitueseve të strehuara dhe

stafit rehabilitues dhe më pas është shfaqur para nxënësve dhe arsimtarëve të shkollës fillore ku përfitueset, aktore të kësaj drame vijnë në mesimin fillor.

Gjatë muajit Tetor, në kuadër të Qendrës së Rehabilitimit, është prezantuar filmi "Taken" para përfitueseve të strehuara në Strehimoren e Qendrës së Rehabilitimit, i cili është diskutuar dhe elaboruar më pas në formë të seancës së vetëdijesimit për Viktimat e Trafikimit.

## Dekada e Qendrës Kosovare për Rehabilitim

Në shtator të këtij viti, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT) mbushi dhjetë vjet ekzistence, pune dhe lufte kundër fenomenit të torturës në Kosovë. Gjatë një dekade veprimtari, QKRMT ka qenë mbështetëse e përhershme e viktimave të torturës, ndërsa paralelisht ka punuar edhe në parandalimin e saj.

Në vjeshtën e vitit 1999, QKRMT filloi të ofrojë shërbime shumë të nevojshme psiko-sociale dhe mjekësore të cilat aplikoheshin për herë të parë në Kosovë duke u munduar të kontribuojnë në zbutjen e vuajtjeve dhe plagëve shpirtërore të shkaktuara nga

lufta. Kështu, pas 10 vjetësh krijuan resurse të reja profesionale që vazhdojnë t'iu dalin ne ndihmë në mënyrë permanente një numri të konsiderueshëm të viktimave të torturës. E gjithë puna e këtij dhjetëvjetëshi në QKRMT është mbështetur nga njerëz profesionistë të fushës së mjekësisë, aktivistë të të drejtave të njeriut, ku edhe kanë arritur të shtrihen në zonat më të ndjeshme të Kosovës dhe u kanë zgjidhur dorën atyre që kanë pasur nevojë.

Drejtoresha Ekzekutive e Qendrës, Feride Rushit është shprehur: "Jemi të vetëdijshëm se dhjetë vjet pune dhe mund nuk janë shumë në kra-

hasim me problemet shoqërore të vendit tonë. Por, në të njëjtën kohë, jemi konfident në mendimin se pa QKRMT-në, kjo kategori shoqërore do ta kishte më të vështirë jetën dhe ballafaqimin me pasojat e torturës. Sfidat dhe obligimet janë të mëdha, ka ende shumë punë për QKRMT-në. Por, në këtë luftë permanente të Qendrës kundër torturës, dëshirojmë që për një moment të shkurtër, të ndalemi dhe ta kujtojmë dekadën e dedikimit të njerëzve të QKRMT-së. Dhe njëherit të shënojmë këtë vit jubilar të veprimtarisë së Qendrës bashkë me miqtë, bashkëpunëtorët, përkrahësit, dhe mbi të gjitha, me klientët tanë".

### Tetori – Muaji Ndërkombëtar i Luftës kundër Kancerit të Gjirit

Iniciativa Ballkanike për luftimin e Kancerit të Gjirit (BBCI) në bashkëpunim me Community Building Mitrovica (CBM), organizoi Ecjen Vjetore të Kosovës për vetëdijesimin ndaj Kancerit të Gjirit (IBKGJ). BBCI është iniciuar nga Ambasada Amerikane në Prishtinë dhe ka gjetur përkrahjen e USAID-it, mjekëve të njohur kosovarë, OJQ-ve kosovare, duke përfshirë këtu edhe OJQ-në e parë në Kosovë, Jeta/Vita, e cila për qëllim të vetëm ka ngritjen e vetëdijesimit së shoqërisë ndaj kancerit të gjirit dhe zbulimin e hershëm të tij.

Me rastin e muajit ndërkombëtar për luftimin e kancerit të gjirit, dhe të përmbylljes së projektit të saj të dytë, Qendra Kosovare për Luftimin e Kancerit të Gjirit "JETA|VITA" ka organizuar tryezë të rrumbullakët. Gjatë kësaj tryeze u dhanë informata për aktivitetet e zhvilluara të QK-LKJ-së dhe informata për rezultatet e Ministrisë së Shëndetësisë lidhur me diagnosticimin dhe trajtimin e kancerit të gjirit. Gjithashtu është debatuar mbi hartimin e strategjisë kombëtare për luftimin e kancerit të gjirit dhe realizimin e projektit Autoambulanca Mobile Mamografike.

Si aktivitet tjetër ishte edhe performansa në Teatrin Oda e mbështetur nga Ministria e Energjetikës dhe Minierave. Në regji të Burbuqe Berishës, aktoret shpalosën para publikut rrëfime të vërteta nga gratë që kanë përjetuar kancerin e gjirit.

**Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës**

info@womensnetwork.org

038 245 850

Hajdar Dushi C-2, II/8

10 000 Prishtinë,

Republika e Kosovës

www.womensnetwork.org

**Stafi i RrGGK**

**Igballe Rogova**

Drejtoreshë Ekzekutive  
igorogova@yahoo.com

**Besa Shehu**

Menaxhere e Financave  
besa\_shehu@yahoo.com

**Alba Loxha**

Menaxhere për Informim  
albaloxha@yahoo.com

**Nicole Farnsworth**

Këshilltare & Hulumtuuese  
nicole.farnsworth@gmail.com

**Adelina Berisha**

Koordinatorë e Projektit  
aberisha@gmail.com

**Bordi i RrGGK**

**Belgjyzare Muharremi**

Kryetare e Bordit

**Ariana Qosaj - Mustafa**

**Arjeta Rexhaj**

**Behar Selimi**

**Nazlije Bala**

**Shukrije Gashi**

**Veproje Shehu**

Bordi Këshillues:

**Besim M. Kajtazi**

**Delina Fico**

**Marte Prenkpalaj**

**Rachel Wareham**

**Vjosa Dobruna**

"Zëri i Gruas Kosovare"  
është përpiluar dhe dizajnuar nga  
Alba Loxha.

www.womensnetwork.org

## Qendra për Mirëqenien e Gruas shënon 16 aktivizëm kundër dhunës ndaj gruas

Nga 25 nëntori deri me 10 dhjetor Qendra për Mirëqenien e Gruas (QMG) shënoi me një sërë aktivitetesh 16 ditët e aktivizimit kundër dhunës ndaj gruas. Moto e fushatës, tashmë të tradicionale për QMG-në, është që ti jepet fund të gjitha formave të dhunës ndaj grave, si dhe rritja e ndërgjegjësimit publik për këtë çështje.

Fushata e kordeles së bardhë është përpjekja më e mëdha në botë e njerëzve që punojnë për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave. Në mbi njëqind vende, fushatat udhëhiqen nga burrat edhe gratë dhe qëllimi është edukimi i burrave dhe djemve.

Si ka filluar fushata e kordeles së bardhë?

Në 1991, disa burra në Kanada duke ndjerë përgjegjësi,

kanë ftuar meshkuj të bise-dojnë për dhunën ndaj grave. Bartja e kordeles së bardhë është një zotim personal që nuk do kryejnë dhe nuk do të heshtin për dhunën ndaj grave dhe vajzave kjo është edhe një mënyre për të thënë "E ardhmja e jonë nuk e pranon dhunën ndaj grave."

QMG inicioj fushatën e kordeles së bardhë në vitin 2001 me qëllim që ti inkurajoj meshkujt kosovar të flasin dhe kundërshtojnë dhunën ndaj gruas, me qëllim të krijimit të

një shoqërie të barabartë në aspektin gjinor.

Aktivitet kryesore të QMG-së gjatë këtyre 16 ditëve ishin: Shpërndarja e Kordeles së bardhë; Debate Televizive; Tubim me moton "Parandalimi i dhunës ndaj gruas"; Trajnime; Tryeza të rrumbullakëta me të rinjët, me përfaqësuesit e institucioneve shoqërore nga komuna e Pejës; etj.

Të gjitha këto aktivitete u organizuan nga Qendra për Mirëqenien e Gruas dhe Shtëpia e Sigurt në Pejë.

*"Mos harroni askush  
nuk mund të ju bëjë  
të ndjeheni inferior pa pëlqimin tuaj."  
Eleanor Roosevelt*

## QTSGJ dërgon letër të hapur Institucioneve Kosovare

Me 7 Dhjetor në kuadër të gjashtëmbëdhjetë ditëve të aktivizimit për "Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas", Qendra për Trajnime dhe Studime Gjimore (QTSGJ), në bashkëpunim dhe mbështetje financiare nga UNIFEM ka organizuar Tryezën e Rrumbullakët me temën: "Krijimi i Strategjive kundër keqpërdorimit me Teknologjinë Informativë dhe atë të Komunikimit - TIK (ICT Cyber Crime) dhe Praktikën e Avancuar Institucionale".

Në këtë tryezë kanë qenë të pranishëm përfaqësues të organizatave qeveritare dhe jo qeveritare (lokale dhe ndërkombëtare), përfaqësues të institucioneve Kosovare, përfaqësues të mediave, shoqërisë civile, Policisë së Kosovës, etj.

Nga kjo tryezë dhe nga fjalimet e të pranishmëve janë nxjerrë këto rekomandime: Të hartohet strategjia nacionale

për luftën kundër krimit Cyber (Krimin Kibernetik); Të forcohet bashkëpunimi mes aktorëve relevant për parandalimin dhe luftën kundër Cyber Krimit; Të krijohet një aleance nacionale për sigurinë nga Krimi Cyber; Të identifikohen aktorët relevant nga Qeveria, Gjuqësia, Policia, Institucionet arsimore, Kompanitë e TIK-ut (Teknologjisë Informativë dhe të Komunikimit), OJQ-të, etj.; Të krijohet programe shkollore dhe organizata/agjensione për parandalimin e Cyber Krimit; Të organizohen fushata për vetëdijësim nga pasojat e kësaj dukurie; Të zhvillohet bashkëpunimi ndërkombëtar në këtë fushë dhe të shfrytëzohen praktikat më të mira rajonale për luftën kundër këtij krimi; Të përshpejtohet aprovimi i ligjit kundër Dhunës në Familje, si dhe të bëhet harmonizimi i të gjitha ligjeve që

mbrojnë të drejtat e grave dhe fëmijëve në Kosovë; dhe Të ndahet një buxhet që do të përdoret në mënyre specifike për implementimin e ligjit kundër keqpërdorimit me TIK.

Këto rekomandime QTSGJ i adresoi edhe në letrën e hapur dërguar Presidentit të Kosovës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit dhe Kryetarëve të Komisioneve Parlamentare.

QTSGJ, në bashkëpunim me organizatat/agjensione të tjera pjesëmarrëse, gjithashtu i rekomandon Qeverisë, Parlamentit dhe Komisioneve Parlamentare që të krijojnë KOMENTAR për të gjitha ligjet e aprovuara dhe ato që janë në proces, pasi që një Komentari i tillë për ligjet mungon në Kosovë dhe ky Komentari është i nevojshëm dhe i domosdoshëm.